



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 651 Akti

Nr. 714 Vendimi

Tiranë, më 15.11.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 15.11.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

KËRKUES: **Z. Besnik Maho**, ish-gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

OBJEKTI: **Kërkesë për t'iu nënshtuar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga kërkuesi, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht – u njoh me shpjegimet e z. Besnik Maho dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Referuar nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “[...] *Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët ... të cilët kanë punuar në këto pozicione për të paktën 3 vjet. [...]*”.

2. Z. Besnik Maho, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, ka kërkuar t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit për të tria kriteret e rivlerësimit, duke plotësuar formularin e vetëvlerësimit profesional dorëzuar pranë ish-KLD-së¹ edhe atë të kontrollit të figurës dorëzuar pranë ish-DSIK-së. Gjithashtu, konstatohet se në kërkesën drejtuar ish-KLD-së dhe ish-DSIK-së, z. Besnik Maho ka kërkuar edhe rivlerësimin e pasurisë.
3. Z. Besnik Maho ka paraqitur kërkesë në datën 31.01.2017, në të cilën kërkon t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar, pasi më parë ka ushtruar detyrën si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe, më pas, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, përgjatë viteve 2005, 2006 dhe 2007. Kërkesa është firmosur nga përfaqësuesja me prokurë të posaçme, znj. A. M. Për rrjedhojë, po nga përfaqësuesja e posaçme A. M. është dorëzuar pranë ish-DSIK-së deklarata për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, dorëzuar bashkë me kërkesën e datës 31.1.2017 edhe formulari i vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dorëzuar pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë², datë 8.11.2016³.
4. Referuar kërkesës datë 31.7.2017, për t'iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe dorëzimit të formularëve të sipërpërmendur, në mbledhjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në datën 15.12.2020 është shortuar kjo çështje, në të cilën është caktuar me short trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bektashi kryesuese, Etleda Çiftja relatores dhe Lulzim Hamitaj anëtar.
5. Pas shortimit të çështjes tek relatori përkatës dhe përcaktimit të trupit gjykues, filloi hetimi administrativ me kërkesë të z. Besnik Maho, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Të gjithë anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
6. Në datën 13.1.2021, përmes postës elektronike⁴, Komisioni njoftoi z. Besnik Maho për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni gjithashtu i kërkoi z. Besnik Maho informacion shtesë sipas pyetësorit standard.
7. Në përgjigje, z. Besnik Maho, në datën 28.1.2021, përmes postës elektronike⁵, ka njoftuar Komisionin se tërheq kërkesën e tij për t'iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit për arsyen se është shpallur fitues në konkurrimin për inspektor pranë ILD-së nga radhët e subjekteve jomagjistratë dhe me vendimin nr. ***, datë 25.1.2021.
8. Në datën 30.4.2021, përmes postës elektronike⁶, Komisioni ndër të tjera i ka kërkuar z. Besnik Maho: (i) konfirmim nga ILD-ja për emërimin si inspektor në këtë institucion nga radhët e subjekteve jomagjistratë; (ii) kërkesë me shkrim për tërheqjen e kërkesës për t'iu nënshtrohet procesit kalimtar të rivlerësimit; (iii) paraqitjen e formularit të deklarimit të pasurisë dhe dokumentacionit justifikues, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se Komisioni deri në momentin e shortimit nuk kishte administruar raportin e vlerësimit të pasurisë nga ILDKPKI-ja, sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

¹ Shkresa nr. *** prot., datë 22.5.2023.

² Shkresa nr. *** prot., datë 22.5.2023.

³ Sipas procesverbalit datë 8.11.2016.

⁴ Email datë 13.1.2021: "Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë".

⁵ Email datë 28.1.2021.

⁶ Email datë 30.4.2021: "Më tej, kërkojmë një konfirmim nga ILD-ja për emërimin tuaj si inspektor pranë ILD-së nga radhët e subjekteve jomagjistratë dhe një kërkesë me shkrim për tërheqjen tuaj nga procesi i rivlerësimit kalimtar".

9. Në përgjigje të *email*-it datë 30.4.2021, z. Besnik Maho, në datën 6.5.2021, me anë të postës elektronike ka vënë në dispozicion të Komisionit vlerësimin që ka kryer Inspektori i Lartë i Drejtësisë në lidhje me kandidaturën e tij si Inspektor nga radhët e subjekteve jomagjistratë, si dhe vendimin e shpalljes së kandidatëve fitues. Më tej, ka informuar Komisionin se në lidhje me kërkesën që ka depozituar më parë për t'u tërhequr kërkesa për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, do të bënte një ndryshim të kësaj kërkesë në qoftë se i gjithë dokumentacioni që ka depozituar është i plotë dhe i mjaftueshëm për t'u vlerësuar si ish-gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Pogradec.

10. Më tej, z. Besnik Maho, në datën 14.5.2021, përmes postës elektronike⁷, sqaron: “Në vijimësi të *email*-it tuaj të datës 30.4.2021, ju kam kthyer një përgjigje me *email*-in e datës 6.5.2016, ku në të njëjtën kohë kam qartësuar pozitën dhe interesin tim profesional që, nëse është e mundur, të vazhdoj procesin e rivlerësimit, duke qenë i dëshiruar të di fillimisht nëse i gjithë dokumentacioni që unë kam depozituar është i plotë dhe i mjaftueshëm për t'u vlerësuar si ish-magjistrat pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Pogradec. Gjithashtu, ju vura në dijeni se procesverbalin e vlerësimit të aspekteve profesionale e kam dorëzuar në ish-KLD, formularin e vlerësimit të figurës e dorëzova në DSIK, ndërsa të gjithë dokumentacionin që lidhet me aspektin ekonomik e kam dërguar me postë në muajin janar 2017. Gjithashtu, për të tria aspektet e mësipërme, të figurës, profesionale dhe pasurore, ju dërgova vendimin nr. ***, datë 25.1.2021, të ILD-së, për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës sime në të tria këto aspekte si inspektor nga radhët e subjekteve jomagjistratë”. Këtij *email*-i të z. Besnik Maho Komisioni i është përgjigjur po me anë të postës elektronike⁸, si vijon: “Referuar *email*-it tuaj Komisioni ka filluar procesin tuaj të rivlerësimit, për të cilin jeni njoftuar me anë të postës elektronike. Deri më tani, Komisioni ka të konfirmuar se ju nuk keni dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë sipas parashikimeve të nenit 31 “Fillimi i procedurës së vlerësimit të pasurisë”, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: “[...] Subjekti i rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë e Kushtetutës, ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit për vlerësimin e pasurisë brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Kërkesa i bashkëlidhet deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të këtij ligji”.

Me sa ne konstatojmë, ju nuk keni paraqitur kërkesë pranë Komisionit apo ILDKPKI-së dhe nuk keni bashkëlidhur deklaratën e pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit, për këtë arsye ne ju kërkuam me email që të provoni deklaratimet tuaja. [...]”.

11. Në datën 18.5.2021, z. Besnik Maho, përmes postës elektronike⁹, shprehet se deklarata e pasurisë së bashku me dokumentacionin shoqërues është nisur në drejtim të ILDKPKI-së nga bashkëshortja e tij A. M., e cila ishte kthyer në Shqipëri për të bërë dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar nga ligji. Në lidhje me personin e tij, vijon z. Besnik Maho, informacioni që lidhet me aspektet pasurore nuk u pranua të dorëzohej në zyrën e protokollit të ILDKPKI-së, për arsye se nuk ishte në atë kohë pjesë e sistemit të organeve të drejtësisë. Gjithashtu, shprehet se dorëzimin e materialeve të vlerësimit profesional e ka kryer personalisht gjatë muajit nëntor 2016 kur ndodhej në Shqipëri për të mbrojtur punimin e

⁷ *Email* datë 14.5.2021, ora 10:33.

⁸ *Email* datë 14.5.2021, ora 12:52.

⁹ *Email* datë 18.5.2021

doktoratës, ndërsa dorëzimin e deklaratës së vlerësimit të figurës në ish-DSIK e ka dorëzuar në emrin e tij znj. A. M.. Bashkëlidhur ka dërguar dokumentacionin provues¹⁰.

12. Komisioni, në datën 21.5.2021, përmes postës elektronike¹¹ vë në dijeni z. Besnik Maho se ka një përgjigje zyrtare nga ILDKPKI-ja, e cila informon se ky shtetas nuk ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Në vijim, Komisioni informon se duke qenë se jemi përpara një prove shkresore nga institucioni kompetent, i takon atij të provojë të kundërtën e kësaj shkrese me anë të një prove tjetër shkresore, që të vërtetojë dorëzimin e kërkesës bashkë me shtojcën 2 tek organi kompetent sipas parashikimeve të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, Komisioni e vë në dijeni se e fillon hetimin për procesin e rivlerësimit vetëm pas administrimit të një raporti të hollësishëm dhe të arsyetuar me konstatimet përkatëse nga institucionet e vlerësimit, në rastin konkret ILDKPKI-ja. Bashkëlidhur, Komisioni ka vënë në dispozicion të kërkuarit shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2021, të ILDKPKI-së.

13. Z. Besnik Maho përmes postës elektronike¹² informon Komisionin se në vijimësi të procesit të rivlerësimit ka përcjellë shkresën zyrtare nr. *** prot., datë 19.5.2021, të shtetasit Sh. K., me detyrë drejtor i filialit të Postës sh. a., Tiranë, ku e vë në dijeni se dokumenti me bar kod nr. *** është depozituar në degën postare Tiranë, në datën 30.1.2017, dhe është dorëzuar në destinacion në datën 1.2.2017.

14. Trupi gjykues, me vendimin datë 17.10.2023, vendosi: (i) të përfundojë hetimin sipas kërkesës së z. Besnik Maho mbi plotësimin e kriterëve për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar sipas relacionit ë paraqitur nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë kërkuarin mbi rezultatet e hetimit kryesisht sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë kërkuarin për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë kërkuarin mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

15. Trupi gjykues, në datën 17.10.2023, përmes postës elektronike¹³, njoftoi kërkuarin mbi: (i) rezultatet e hetimit për kërkesën e z. Besnik Maho për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar; (ii) dhënien e shpjegimeve dhe/ose paraqitjen e provave sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën jo më vonë se data 20.10.2023; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

16. Në datën 24.10.2023, z. Besnik Maho paraqiti me anë të postës elektronike¹⁴ pretendimet me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit mbi plotësimin e kriterëve për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar.

¹⁰Prokurë e posaçme datë 20.10.2016, lëshuar në *** të SHBA-së; procesverbal datë 8.11.2016 i vlerësimit të aspekteve profesionale të dorëzuara në ish-KLD; deklaratë e pasurisë së subjekteve magjistratë, si dhe të atyre që kanë qenë magjistratë dhe kërkojnë të rivlerësohen, datë 23.1.2017; vërtetim i dorëzimit të deklaratës së pasurisë nga Zyra Qendrore e Postës Shqiptare, datë 31.1.2017 (të dhëna elektronike të aplikimit të kryer), nëpërmjet shërbimit rekomandë.

¹¹ Email datë 21.5.2021.

¹² Email datë 25.5.2021.

¹³Email datë 17.10.2023: "Komisioni – Njoftim mbi rezultatet e hetimit kryesisht sipas kërkesës suaj".

¹⁴Email datë 24.10.2023: "Re: Komisioni – Njoftim mbi rezultatet e hetimit administrativ sipas kërkesës suaj".

17. Komisioni, në respektim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, me anë të postës elektronike¹⁵ i kërkoi z. Besnik Maho konfirmimin nëse kërkon të dëgjohet në seancë dëgjimore publike lidhur me qëndrimin e tij.

18. Në përgjigje¹⁶, z. Besnik Maho sqaron se: “...nuk e kuptoj qëllimin e zhvillimit të një seance dëgjimore publike për t’u dëgjuar vetëm për një aspekt procedural, nëse i kam ushtruar ose jo më pak se tri vite pune si gjyqtar. Sqarimin e plotë dhe të qartë të kësaj çështjeje procedurale e kam ezauruar tërësisht në sqarimin e datës 24.10.2023, drejtuar zyrtarisht Komisionit në rrugë elektronike”.

19. Në vijim, Komisioni me anë të postës elektronike¹⁷ i kërkoi dhe një herë z. Besnik Maho të deklarojë qartësisht nëse dëshiron të dëgjohet në seancë dëgjimore.

20. Në përgjigje¹⁸, z. Besnik Maho deklaroi se: “Nuk jam kundër zhvillimit të një seance dëgjimore, e cila duhet të jetë rezultat i një procesi të rregullt hetimor administrativ, ku duhet të vijohet me pyetësorët që i çmon të nevojshëm Komisioni (sikurse është vepruar në muajin janar 2021, por nuk u vijua më tej), kthimin e përgjigjeve rreth këtij pyetësori dhe gjithë pyetësorëve të tjerë të nevojshëm së bashku me kthimin e përgjigjeve të mia, në mënyrë që të konkludohet me relacionin e hetimit administrativ të zhvilluar, praktikë kjo e ndjekur për të gjithë magjistratët e rivlerësuar. Për rrjedhojë, nuk jam dakord me konkluzionet përfundimtare të evidentuara në relacionin e përgatitur nga KPK-ja, pa një proces të rregullt ligjor, duke u mjaftuar vetëm në dhënien mundësi që të marr pjesë në seancë dëgjimore, pa u zhvilluar më parë një hetim i rregullt administrativ sipas dispozitave të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 42 të Kushtetutës”.

21. Në kushtet kur z. Besnik Maho nuk është përgjigjur në mënyrë të qartë lidhur me pyetjen e Komisionit nëse dëshiron të paraqitet në seancë dëgjimore për të dhënë shpjegimet e tij, trupi gjykues me anë të postës elektronike¹⁹ njoftoi kërkuesin se vendosi ta ftojë për t’u dëgjuar lidhur me rezultatet e hetimit në seancë dëgjimore, datë 13.11.2023, ora 13:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

22. Kërkuesi me anë të postës elektronike²⁰ deklaroi se: “... nuk kam qenë dhe nuk do të jem asnjëherë kundër zhvillimit të një seance dëgjimore që është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor në bazë të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Seanca dëgjimore e datës 13.11.2023, ora 13:00, nuk respekton nenin 42 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ-së dhe dispozitat urdhëruese të Kodit të Procedurave Administrative që kanë të bëjnë me një proces të rregullt ligjor”.

II. SEANCA DËGJIMORE

23. Në datën 13.11.2023 u zhvillua seanca dëgjimore në mungesë të kërkuesit Besnik Maho dhe me praninë e vëzhguesit ndërkombëtar Gerrit Sprenger.

24. Trupi gjykues konstatoi se z. Besnik Maho nuk u paraqit në seancë pa ndonjë shkak të arsyeshëm, megjithëse ka pasur dijeni rregullisht për datën dhe orën e seancës²¹. Në këto

¹⁵ Email datë 27.10.2023.

¹⁶ Email datë 27.10.2023.

¹⁷ Email datë 1.11.2023 “Komisioni – Njoftim mbi rezultatet e hetimit kryesisht sipas kërkesës suaj”.

¹⁸ Email datë 1.11.2023.

¹⁹ Email datë 9.11.2023.

²⁰ Email datë 10.11.2023.

²¹ Transkriptim telefonik – mesazh.

kushte, trupi gjykues bazuar në nenin 34, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, vendosi vazhdimin e gjykimit pa praninë e kërkuarit.

25. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kaluara si barrë prove për shpjegime.

26. Seanca dëgjimore e datës 13.11.2023 u ndërpre, për të rifilluar në datën 15.11.2023, ora 9:45, për shpalljen e vendimit.

III. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

27. Procesi i rivlerësimit kalimtar, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

28. Referuar vendimit nr. 2/2017²² të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

29. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit prej Këshillit të Lartë Gjyqësor²³ rezulton se z. Besnik Maho, me Dekretin nr. ***, datë 17.9.2004, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar dhe është caktuar të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Më pas, me Dekretin nr. ***, datë 3.10.2005, të Presidentit të Republikës, është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

30. Në datën 13.6.2007, z. Besnik Maho ka paraqitur pranë ish-KLD-së kërkesën për t’u dorëhequr nga funksioni i gjyqtarit dhe miratimin e kërkesës për t’u angazhuar në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë.

31. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. *** prot., datë 18.6.2007, i ka kërkuar ish-KLD-së të miratojë kërkesën për dorëheqje të z. Besnik Maho dhe dhënien e pëlqimit për kalimin e tij me detyrë pranë Ministrisë së Drejtësisë, me argumentin se angazhimi i tij në nivelet drejtuese të strukturave juridike të Ministrisë së Drejtësisë nuk e zhvesh gjyqtarin Besnik Maho nga statusi.

32. KLD-ja, me vendimin nr. ***, datë 19.6.2007, ka vendosur pranimin e kërkesës për dorëheqje dhe lirin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

33. Me VKM-në nr. 392, datë 28.6.2007, “Për lirim dhe emërim në detyrë”, z. Besnik Maho emërohet drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Më pas, me VKM-në nr. 627, datë 21.5.2008, z. Besnik Maho shkarkohet nga kjo detyrë.

²² “Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

²³Shkresa nr. *** prot., datë 22.5.2023.

34. Sipas informacionit të përcjellë nga KLGJ-ja me anë të postës elektronike²⁴, z. Besnik Maho në periudhën maj – tetor 2008 ka kryer kurs veror për gjuhën angleze në SHBA; në periudhën tetor 2008 – mars 2015 ka punuar pedagog në Universitetin *** të Tiranës; në periudhën maj 2015 – gusht 2016 ka vazhduar studimet si *houseman* dhe student në SHBA.

35. Në vijim, rezulton se në datën 8.11.2016 z. Besnik Maho ka dorëzuar pranë ish-KLD-së²⁵ formularin e vetëvlerësimit profesional, duke i bashkëlidhur dokumentacionin përkatës.

36. ILDKPKI-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2021, informon Komisionin se z. Besnik Maho nuk ka dorëzuar pranë këtij institucioni deklaratën e pasurisë në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

37. Komisioni²⁶ i kërkoi KLGJ-së informacion nëse: (i) z. Besnik Maho nga data 21.5.2008 e në vijim ka paraqitur kërkesë për t’u rikthyer në detyrën e gjyqtarit; (ii) nëse ish-KLD-ja ka marrë vendim për statusin e tij, si dhe kërkoi opinionin e KLGJ-së lidhur me pasjen ose jo të statusit të magjistratit të z. Besnik Maho.

38. Në përgjigje, KLGJ-ja²⁷ ka përcjellë pranë Komisionit: (i) kërkesën nr. *** prot., datë 13.9.2013, të z. Besnik Maho, për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) raportin nr. *** prot., datë 11.12.2013, të ish-KLD-së “Mbi rezultatet e pikëzimit të kandidatëve për 13 vende vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor”; (iii) procesverbalin e mbledhjes plenare të ish-KLD-së së datës 16.12.2013. Gjithashtu, KLGJ-ja sqaron se në dosjen personale të z. Besnik Maho nuk rezultojnë kërkesa të tij për t’u rikthyer në detyrën e gjyqtarit, ndërsa lidhur me pasjen ose jo të statusit të magjistratit nuk është shprehur.

39. Nga informacioni i administruar nga KLGJ-ja rezulton se në datën 13.9.2013 z. Besnik Maho ka paraqitur kërkesë në KLD për t’u rikthyer në detyrën e gjyqtarit, duke pasqyruar, ndërmjet të tjerave, si shkak, se në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 8678/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i lind e drejta të kërkojë rikthimin në sistemin gjyqësor.

40. Në raportin nr. *** prot., datë 11.12.2013, të KLD-së “Mbi rezultatet e pikëzimit të kandidatëve për 13 vende vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor”, rezulton se z. Besnik Maho figuron në renditje i pari në listën e kandidatëve “jo gjyqtarë magjistratë”, ndërsa sipas procesverbalit të mbledhjes së datës 16.12.2013 nuk rezulton që ky organ të ketë marrë në shqyrtim kërkesën e tij për t’u rikthyer si gjyqtar.

41. Në kushtet kur KLGJ-ja nuk është shprehur lidhur me pasjen ose jo të statusit të magjistratit të z. Besnik Maho, Komisioni²⁸ kërkoi dhe një herë nga KLGJ-ja informacion nëse aktualisht z. Maho ka ose jo statusin e magjistratit dhe, nëse jo, kohën kur e ka humbur këtë status. Në përgjigje²⁹, Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional i KLGJ-së sqaron se referuar nenit 30/a të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 4 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, përditësuar në vitin 2003, nenit

²⁴ Email datë 2.5.2023.

²⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 22.5.2023.

²⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 13.6.2023.

²⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 21.6.2023.

²⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 13.9.2023.

²⁹ Shkresa nr.*** prot., datë 2.10.2023.

28 të ligjit 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, z. Besnik Maho nuk e ka aktualisht statusin e gjyqtarit.

42. Nga analizimi i fakteve të mësipërme, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi z. Besnik Maho barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime të tjera në lidhje me konstatimin se: “Z. Besnik Maho nuk është subjekt rivlerësimi, pasi nuk plotëson kriterin e parashikuar nga pika 4 e nenit 179/b të Kushtetutës, që të ketë punuar të paktën 3 vjet në pozicionin e gjyqtarit. Në këtë kuptim, duket se Komisioni është në kushtet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për z. Besnik Maho, pa një vendim përfundimtar për çështjen”.

43. Në përgjigje³⁰, z. Besnik Maho fillimisht shpjegon se relacioni i hetimit i është vënë në dispozicion pa zhvilluar hetim nëpërmjet procedurës së rregullt që kërkon ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Kushtetuta e Republikës të Shqipërisë, pasi nuk i është dhënë mundësia me pyetje-përgjigje në bazë të pyetësorëve të nevojshëm si gjithë magjistarët e tjerë të rivlerësuar, duke sjellë si pasojë mospasjen e një procesi të rregullt hetimor administrativ të zhvilluar në aspektin e kontradiktoritetit dhe mbrojtjes. Gjithashtu, shpjegon se koha që të bëjë sqarime apo prapësime në lidhje me gjetjet e konstatuara, për 4 ditë, është një kohë tërësisht e pamjaftueshme për një mbrojtje efektive.

44. Më pas, lidhur me arsyetimin e Komisionit se duhet të verifikohet fillimisht aspekti procedural, nëse kishte punuar jo më pak se tri vite gjyqtar, z. Maho sqaron se është një qëndrim që nuk qëndron në këtë fazë të procesit hetimor administrativ të zhvilluar, pasi ka provuar plotësimin e kriterëve formale të vijimit të procesit hetimor në tri kriterë.

45. Në vijim, lidhur me konstatimin se nuk plotëson afatin e ushtrimit të detyrës për të paktën tre vjet, z. Besnik Maho shpjegon se nuk i është kërkuar të japë sqarime gjatë muajve janar-maj 2021 dhe se ky konstatim nuk qëndron pasi, duke drejtuar një organ *quasi* gjyqësor të njohur nga praktika e GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës të Shqipërisë³¹, ka vijuar të ketë të gjitha të drejtat e magjistratit dhe i njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale deri në datën 21.5.2008, kur është shkëputur nga ky organ, sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”. Si përfundim, vijon z. Besnik Maho, nga data 17.9.2004, që ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe deri në datën 21.5.2008, janë më shumë se tri vite periudhë vjetërsie si gjyqtar për efekt të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

IV. VLERËSIMI I KOMISIONIT PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT PA VENDIM PËRFUNDIMTAR

A. Mbi aspektet procedurale të parashtruara nga kërkuesi

46. Lidhur me pretendimin e kërkuesit se relacioni i rezultateve të hetimit i është vënë në dispozicion pa zhvilluar hetim nëpërmjet procedurës së rregullt që kërkon ligji nr. 84/2016, pasi nuk i është dhënë mundësia me pyetje-përgjigje në bazë të pyetësorëve të nevojshëm si gjithë magjistarët e tjerë të rivlerësuar, Komisioni arsyeton se procedura e rivlerësimit parashikohet në kreun VII të ligjit nr. 84/2016, ku, ndërmjet të tjerave, përcaktohet se organet e

³⁰ Email datë 24.10.2023.

³¹ Subjekti i referohet emërimit si drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

rivlerësimi mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike dhe të administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit³². Më pas parashikohet se njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit³³ dhe të drejtat e tij gjatë procesit të rivlerësimit rregullohen sipas përcaktimeve të neneve 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, në të cilat parashikohet e drejta e subjekteve për të kryer veprimet procedurale personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit, si dhe e drejta e tyre për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur mendime e shpjegime.

47. Referuar parashikimeve të mësipërme ligjore, Komisioni, në kuadër të verifikimit të kriterëve të parashikuara nga neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës, ka administruar dokumentacionin e nevojshëm nga KLGJ-ja për vërtetimin e fakteve që kanë lidhje me kohën e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit nga kërkuesi. Në vijim, me anë të postës elektronike, kërkuesi është njoftuar lidhur me problematikat që janë hasur gjatë hetimit administrativ për sa i përket dokumentacionit të paraqitur prej tij për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, si dhe ka administruar provat e paraqitura nga kërkuesi përmes postës elektronike. Më pas, Komisioni, në datën 17.10.2023, përmes postës elektronike³⁴ ka njoftuar kërkuesin lidhur me rezultatet e hetimit dhe me të drejtën për t'u njohur me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit. Njoftimi i datës 13.1.2021 i Komisionit përmes postës elektronike lidhur me përbërjen e trupit gjykues, duke kërkuar informacion shtesë sipas pyetësorit standard, është një veprim procedural i Komisionit për të gjitha subjektet e shortuara dhe nuk presupozon vlerësimin e kriterëve kushtetuese për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit.

48. Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk i është dhënë mundësia me pyetje-përgjigje në bazë të pyetësorëve të nevojshëm si gjithë magjistratët e tjerë të rivlerësuar, Komisioni arsyeton se kërkuesi ka paraqitur kërkesë që t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar e, për pasojë, fillimisht ka hetuar nëse z. Besnik Maho plotëson në mënyrë kumulative kriteret e parashikuara në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar dhe nëse do të rezultonte se i plotëson këto kriteret do të vijehej me përfshirjen në procesin e rivlerësimit.

49. Lidhur me pretendimin se koha që të bëjë sqarime apo prapësime me gjetjet e konstatuara, për 4 ditë, është një kohë tërësisht e pamjaftueshme për një mbrojtje efektive, Komisioni arsyeton se në relacionin e rezultateve të hetimit është arritur në përfundimin se z. Besnik Maho nuk është subjekt rivlerësimi, pasi nuk plotëson në mënyrë kumulative kriteret e parashikuara nga pika 4 e nenit 179/b të Kushtetutës: “(i) të ketë punuar gjyqtar; (ii) të ketë punuar të paktën 3 vite në këtë pozicion”, në këto kushte, duke vlerësuar kompleksitetin e çështjes, kërkuesit i është kërkuar të paraqesë shpjegimet e tij me shkrim brenda 3 ditëve. Megjithatë, pavarësisht se kërkuesi i paraqiti shpjegimet e tij përtej afatit të përcaktuar nga Komisioni, ato u administruan dhe u vlerësuan, duke mos cenuar të drejtën e tij për një mbrojtje efektive.

³² Ligji nr. 84/2016, neni 45, parashikon: “2. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të këtij ligji. Ata administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit”.

³³ Po aty, neni 46, parashikon: “1. Njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit, që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1 e këtij ligji...”.

³⁴ Email datë 17.10.2023 “Komisioni - Njoftim mbi rezultatet e hetimit administrative sipas kërkesës suaj”.

50. Nga hetimi administrativ rezulton se z. Besnik Maho në datën 17.9.2004³⁵ është emëruar gjyqtar dhe është caktuar të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në datën 3.10.2005³⁶ është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Më pas, në datën 28.6.2007³⁷, z. Besnik Maho emërohet drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) dhe në datën 21.5.2008³⁸ është shkarkuar nga kjo detyrë. Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 me ligjin nr. 76/2016, rezulton se z. Besnik Maho nuk e ka emrin në listën e përcjellë nga ish-KLD-ja. Gjithashtu rezulton se Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional të KLGJ-së konfirmon se z. Besnik Maho nuk e ka statusin e magjistratit.

51. Në vijim, Komisioni analizoi dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën kur z. Maho ka kaluar në detyrën e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, si dhe ato pas shkarkimit të tij nga kjo detyrë në raport me faktet e konstatuara nga hetimi administrativ, si më poshtë.

52. Në kohën kur z. Besnik Maho është emëruar drejtor i përgjithshëm i AKKP-së, në datën 3.10.2005, në fuqi ishte ligji nr. 8436, datë 18.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikonte se gjyqtarët mund të shërbejnë në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë dhe kjo periudhë njihet periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar, për efekt të kërkesave të karrierës profesionale³⁹, si dhe ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar⁴⁰, që parashikonte se gjyqtarët që ishin emëruar në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë me kërkesë të tyre rrimërohen përsëri gjyqtarë pa konkurs⁴¹.

53. Më pas, kur kërkuesi është shkarkuar nga detyra e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, në datën 21.5.2008, në fuqi ishte ligji nr. 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”⁴², i cili parashikonte se në përfundim të afatit të ushtrimit të detyrës në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës⁴³.

³⁵ Dekreti nr. ***, datë 17.9.2004, i Presidentit të Republikës.

³⁶ Dekreti nr. ***, datë 3.10.2005, i Presidentit të Republikës.

³⁷ VKM nr. 392, datë 28.6.2007 “Për lirim dhe emërim në detyrë”.

³⁸ VKM nr. 627, datë 21.5.2008 “Për shkarkimin dhe emërim në detyrë”.

³⁹ Neni 30/a (shtuar me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000) parashikon: “Gjyqtarët mund të shërbejnë në nivele drejtuese të kabinetit të ministrit dhe strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. Periudha e shërbimit civil të tyre në këto strukturat njihet periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat e ligjeve për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe të Prokurorisë. Gjyqtarët që shërbejnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë, me kërkesë të tyre, rrimërohen gjyqtarë pa konkurs”.

⁴⁰ I ndryshuar me ligjin nr. 9112, datë 24.7.2003.

⁴¹ Neni 4 parashikon: “...3. Gjyqtarët dhe prokurorët mund të shërbejnë si këshilltarë ligjorë dhe në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Pranimi dhe emërimi i gjyqtarëve a prokurorëve bëhet pasi të jetë dhënë pëlqimi, përkatësisht nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas kërkesës së ministrit të Drejtësisë. Për vendet vakante në nivele drejtuese dhe ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë, pranimi dhe emërimi bëhet pa konkurs.

5. Periudha e ushtrimit të funksionit politik a të shërbimit civil në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar a prokuror për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe prokurorinë.

6. Gjyqtarët a prokurorët që shërbejnë në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, me kërkesë të tyre, rrimërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs”.

⁴² Publikuar në datën 29.2.2008 në Fletoren Zyrtare, nr. 27.

⁴³ Ligji nr. 9877/2008, neni 28, parashikon: “1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës”.

54. Nga informacioni i administruar nga KLGJ-ja rezultoi se z. Besnik Maho pas shkarkimit nga detyra e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së nuk ka paraqitur kërkesë për t'u rikthyer në vendin e tij të punës si gjyqtar, por rezultoi se pas një periudhe prej më shumë se 5 vitesh nga momenti i shkarkimit, në datën 13.9.2013 ka paraqitur kërkesë pranë ish-KLD-së për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, më pas, deri në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, nuk ka paraqitur kërkesë për t'u rikthyer si gjyqtar.

55. Sa më sipër, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktet se: (i) z. Besnik Maho nuk e ka emrin në listat e përcjella nga organi kompetent, ish-KLD; (ii) Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional të KLGJ-së konfirmon se z. Maho nuk e ka statusin e magjistratit – vlerëson se në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese në vitin 2016, kërkuesi Besnik Maho nuk e ka statusin e magjistratit, për shkak se pas shkarkimit të tij nga detyra e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së nuk ka paraqitur kërkesë pranë KLD-së për t'u rikthyer në vendin e mëparshëm të punës si gjyqtar, duke e humbur për shkak të ligjit (*ex lege*) statusin e magjistratit.

B. Vlerësimi i plotësimit në mënyrë kumulative të kriterëve kushtetuese për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit

56. Komisioni fillimisht vlerësoi nëse z. Besnik Maho plotëson në mënyrë kumulative kriteret kushtetuese për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar.

57. Kushtetua, në pikën 4 të nenit 179/b, parashikon: “...Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tri vjet”.

58. Ligji nr. 84/2016, në pikën 16 të nenit 3, parashikon: “16. “Subjekt rivlerësimi janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës”. Në vijim, neni 31, pika 2 parashikon: “2. Subjekti i rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalë e dytë, të Kushtetutës, ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit për vlerësimin e pasurisë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Kërkesa i bashkëlidhet deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të këtij ligji”. Më pas, neni 41, pika 2 parashikon: “2. Subjekti i rivlerësimit, i parashikuar në nenin 179/b, pika 4, fjalë e dytë, të Kushtetutës, ka të drejtë t'i paraqesë me shkrim Komisionit kërkesën për rivlerësimin e tij brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Kërkesa i bashkëlidhet formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të këtij ligji”.

59. Më tej, sipas pikës 1 të nenit 166 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar: “Kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e rivlerësimit personat, të cilët janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe që kanë ushtruar funksionin si magjistrat të paktën për tri vjet...”.

60. Në analizë të dispozitave të mësipërme, Komisioni vlerësoi fillimisht të verifikojë nëse: (i) z. Besnik Maho është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe është emëruar gjyqtar; (ii) e ka ushtruar detyrën e gjyqtarit për të paktën 3 vjet.

61. Lidhur me kriterin e (i) diplomimit dhe emërimit gjyqtar të z. Besnik Maho, nga hetimi administrativ rezultoi e provuar se z. Maho është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës me diplomën nr. ***, nr. regjistri ***, për periudhën tetor 2002 – tetor 2005, me titullin “Magjistrat Gjyqtar”. Më tej, me Dekretin nr. ***, datë 17.9.2004, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar dhe është caktuar të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Elbasan. Pas përfundimit të stazhit profesional, me Dekretin nr. ***, datë 3.10.2005, është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, funksion të cilin e ka ushtruar deri në datën 19.6.2007. Më tej, KLD-ja, me vendimin nr. ***, datë 19.6.2007, ka vendosur pranimin e kërkesës për dorëheqje dhe lirim nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për t'u angazhuar në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë.

62. *Lidhur me kriterin (ii) e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit për të paktën 3 vjet*, trupi gjykues mori në analizë vitet e punës si gjyqtar pas emërimit. Referuar dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën kur z. Besnik Maho ka ushtruar detyrën e gjyqtarit, si dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁴⁴, vlerëson se në dispozitat e ligjit nr. 8136/1996, “Për Shkollën e Magjistraturës”, të ndryshuar, parashikohet se individët që ndjekin studimet në këtë shkollë janë të titulluar si “kandidatë për magjistratë”, duke filluar me përmbajtjen e nenit 1 dhe deri në nenin 21 të tij. Në nenin 22 parashikohet sanksioni për magjistratët e emëruar, të cilët nuk pranojnë të ushtrojnë funksionet në vendin e emërimit, ligji ndryshon terminologjinë për kualifikimin e tyre nga “kandidatë për magjistratë” në “magjistratë”. Kjo dispozitë e ligjit e lidh fitimin e këtij titullit me emërimin e tyre, duke bërë një dallim të qartë mes statusit të tyre si “kandidatë për magjistratë” deri në fund të stazhit profesional dhe në “magjistratë” vetëm pas emërimit që kryhet pas mbarimit të këtij stazhi, në përfundim të studimeve të plota në këtë shkollë.

63. Në këtë kuptim, Komisioni vlerëson se llogaritja e afatit të ushtrimit të detyrës të z. Besnik Maho fillon nga data 3.10.2005, kur është emëruar/caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, pas përfundimit të periudhës së stazhit profesional.

64. Në analizë të datave të sipërcituara, z. Besnik Maho, me Dekretin nr. ***, datë 3.10.2005, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe ka ushtruar funksionin e gjyqtarit deri në datën 19.6.2007 dhe duke llogaritur këtë periudhën kohore rezulton se z. Maho ka punuar në pozicionin e gjyqtarit për një periudhë 1 vit, 8 muaj dhe 16 ditë.

65. Megjithatë, edhe nëse do të llogaritet periudha e ushtrimit të detyrës nga data 17.9.2004, kur z. Maho është caktuar të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, deri në datën 19.6.2007, kur ish-KLD-ja ka vendosur pranimin e kërkesës së tij për dorëheqje dhe lirim nga detyra e gjyqtarit, përsëri nuk e plotëson afatin e ushtrimit të detyrës për të paktën 3 vjet.

66. *Lidhur me pretendimin e kërkuar se periudha që ka punuar si drejtor i përgjithshëm i AKKP-së duhet t'i njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar*, Komisioni arsyeton se referuar dispozitave ligjore në fuqi të kohës kur z. Besnik Maho është emëruar në detyrën e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, në fuqi ishte ligji nr. 8678/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, që përcaktonte se gjyqtarët dhe prokurorët mund të shërbejnë si këshilltarë ligjorë dhe në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë dhe kjo periudhë njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar a prokuror për efekt të kërkesave të karrierës profesionale dhe me kërkesë të tyre riemërohen pa konkurs⁴⁵.

⁴⁴ Vendimi nr. 39, datë 25.10.2022 (E. M. N.).

⁴⁵ Ligji nr. 8678/2001, neni 4, parashikon: “...3. Gjyqtarët dhe prokurorët mund të shërbejnë si këshilltarë ligjorë dhe në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë...”

5. Periudha e ushtrimit të funksionit politik a të shërbimit civil në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, njihet si

67. Më pas hyri në fuqi ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, që parashikonte se gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve dhe pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës dhe periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale. Gjithashtu, parashikonte se periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kanë shërbyer në institucionet e mësipërme para hyrjes në fuqi të këtij ligji⁴⁶, duke pasur fuqi prapavepruese. Në këtë ligj ishte sanksionuar paprekshmëria e statusit të gjyqtarit dhe palëvizshmëria e tij, si garanci që u jepej gjyqtarëve në momentin që ata emëroheshin në detyrë, si dhe rastet kur mund të humbte statusi⁴⁷.

68. Në analizë të parashikimeve të mësipërme ligjore konstatohet se gjyqtarët mund të shërbenin për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, pedagogë ose drejtorë në Shkollën e Magjistraturës etj., duke ruajtur statusin e tyre. Në këtë kuptim, ekzistonte një ndarje ndërmjet statusit të gjyqtarit dhe detyrës së tij, në kushtet kur gjyqtari e ruante statusin dhe kur ushtronte detyra të tjera jashtë pushtetit gjyqësor.

69. Në vijim, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, është miratuar ligji nr. 96/2016, i cili, në nenin 2, shkronja “e”, parashikon se “i emëruar” është personi i cili është diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe është emëruar si magjistrat nga Këshilli ose një ish-gjyqtar ose prokuror që është riemëruar nga Këshilli, por nuk është caktuar ende në pozicion. Në nenin 39 të këtij ligji parashikohen kriteret për caktimin në pozicion të magjistratëve të emëruar. Pra, ligji e ndan konceptin e *emërimit si magjistrat dhe magjistratit në detyrë apo pozicion*⁴⁸.

70. Pika 4 e nenit 179/b të Kushtetutës parashikon se procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët dhe ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën 3 vjet. Në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese, kërkohet që ish-gjyqtari të ketë punuar në pozicionin e gjyqtarit për të paktën 3 vjet.

71. Bazuar në analizën e mësipërme, Komisioni arrin në përfundimin se z. Besnik Maho nuk plotëson në mënyrë kumulative kriteret për t’iu nënshtroar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar, për shkak të mosplotësimit të kriterit kushtetues, i cili kërkon ish-gjyqtarët të kenë punuar në këto pozicione të paktën 3 vjet.

periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar a prokuror për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe prokurorinë.

6. Gjyqtarët a prokurorët që shërbejnë në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs”.

⁴⁶ Ligji nr. 9877/2008, neni 28, parashikon: “1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjorë ose këshilltarë të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Apelit, prokurorë, pedagogë ose drejtorë në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës...”

3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe karrierës profesionale.

4. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

⁴⁷ Neni 20 parashikon: “Gjyqtari nuk mund të lëvizë nga detyra, përveç rasteve kur: a) jep dorëheqjen; b) mbush moshën 65 vjeç, të daljes në pension; c) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi; ç) shkarkohet nga detyra”.

⁴⁸ Vendimi nr. 2 (JR), datë 27.2.2020 (pg. 16.3), i Kolegjit.

72. Edhe në një arsyetim ndryshe, nëse për efekt të llogaritjes do të merrej në konsideratë pretendimi i subjektit se duhet të përfshihet edhe periudha 19.6.2007 – 21.5.2008, përsëri nuk plotësohet afati 3-vjeçar në pozicionin e gjyqtarit. Për pasojë, Komisioni çmon se kërkuesi ka punuar në pozicionin e gjyqtarit nga data e emërimit 3.10.2005 deri më 19.6.2007, duke mos i plotësuar në mënyrë kumulative kriteret e vendosura nga pika 4 e nenit 179/b të Kushtetutës.

73. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se z. Besnik Maho nuk është subjekt rivlerësimi sipas përkufizimit të parashikuar në pikën 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk është në rrethin e personave të përfshirë në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës, duke qenë se nuk plotëson në mënyrë kumulative kriteret për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, për shkak se nuk ka punuar të paktën 3 vjet në pozicionin e gjyqtarit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës si gjyqtar, vendosi përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar pa një vendim përfundimtar për z. Besnik Maho, për shkak se nuk ka punuar për një periudhë 3-vjeçare në detyrën e gjyqtarit sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikën 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për kërkuesin Besnik Maho.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet kërkuesit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga kërkuesi dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.11.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese (kundër)

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Resilda Bilaj